



165/16
31.03.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/
PROCUREMENT REVIEW BODY

REFERENCË:					
PËR/ZATO:		Abdullah Hoti - Ministër në Ministrinë e Financave			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Ardian Behra - Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së			
NGA/OD/FROM:		Agim Sheqiri, Zyrtar Kryesor Financiar - OSHP			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2017-2019			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:	7	Kucni:	Rr."Garibaldi"	Datum:	31.03.2016
Room No.:		Extension:	përball Hotel Grand	Date:	

I/e nderuar

Sipas shkresës se datës 22.03.2016 të lëshuar nga Ministria e Financave (MF), OSHP i dorëzon në tri gjuhët shqip, anglisht dhe serbisht Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2017-2019, përmes së cilës kemi paraqit trendët e shpenzimit për vitin 2015, financimin për vitin 2016 dhe kufijtë e shpenzimeve të vlerësuara për vitet 2017, 2018 dhe 2019, dhe përmes kësaj kornize konsiderojmë se do të përmbushim objektivat e parapara për vitet në vijim.

Gjithashtu ju njoftojmë se për kategorinë mallra dhe shërbime dhe për komunalit për tri vitet në vijim është planifikuar sipas rekomandimeve të Ministrisë së Financave duke iu përmbajtur kufijve aktual të buxhetit.

Me respekt,

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2017-2019

1. Misioni

Misioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) është kryerja e funksioneve që i janë caktuar sipas Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë (Ligji Nr. 04/L – 042) ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr 05/L-092 dhe Ligjit për procedurën për dhënien e koncesioneve (Ligji Nr. 04/L-045) lidhur me ankesa e parashtruara nga operator te ndryshëm ekonomik.

2. Situata aktuale

Organi Shqyrtues i Prokurimit si një institucion i pavarur, është përpjekur të sigurojë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, si dhe respektimin e procedurave ligjore nga ana e Autoriteteve Kontraktuese, konform LPP-së dhe legjislacionit sekondar, duke u mbështetur në ankesat dhe kërkesat operatorëve ekonomikë, OSHP si synimin ka garantimin të drejtave të tyre.

Synimet për vitin 2016 dhe vitet ne vijim, përfshijnë vazhdimin e përpjekjeve për konsolidimin e institucionit, si nga pikëpamja strukturale po ashtu edhe nga organizimi i punës së OSHP-së, konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me operatorët ekonomik, autoritetet kontraktuese si dhe për zbatimin e strategjisë së komunikimit.

Struktura e Organit Shqyrtues të Prokurimit përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarët e Bordit, si dhe stafi mbështetës i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së. Në funksion të organizimi Organi Shqyrtues i Prokurimit ka miratuar Rregulloren e Punës së OSHP-së me datë 22.06.2015 me nr. të 02/2015, në të cilën përcaktohen qartë detyrat e Kryetarit të OSHP-së dhe të anëtarëve të Paneleve Shqyrtuese, si dhe procedurat e komunikimit ndërmjet tyre. Gjithashtu është paraparë edhe funksionimi Njesisë së Brendshme dhe Njesisë për Shqyrtimin e Ankesave.

Me data: 19.03.2014 Kuvendi Kosovës ka emëruar Bordin e OSHP-se ne përbërje kryetari dhe katër anëtar tjerë me mandat pesë vjeçar dhe ne fund të periudhës 2015 Bordi ka rezultuar me 4 anëtar .

Për vitin 2016 për OSHP është është ndarë ë buxheti në vlerë prej 329,8823.99 € ose rreth 0.096% më tepër në krahasim me vitin 2015.

3. Objektivat

Për të realizuar misionin e saj, OSHP-ja në periudhën afatgjate planifikon që me buxhetin e paraparë në KASH për vitet 2017-2019, të realizojë këto objektiva:

1. Objektivi kryesor i Organit Shqyrtues të Prokurimit është që të jetë në shërbim të operatoreve ekonomik dhe të mbroje të drejtat e ligjshme nga veprimet apo mos veprimet e Autoriteteve Kontraktuese. Rendësi të veçante për arritjen e kësaj objektive do të kushtohet profesionalizmit, efikasiteti dhe vendimmarrjes së drejtpërdrejtë, dhe për përmbushjen e kësaj objektive OSHP parasheh që të ngrit në vazhdimësi kapacitetet institucionale dhe për këtë parashihej që të shpenzohet rreth 30% e buxhetit organizativ.
2. Objektivi i dytë e OSHP-se do të jetë rritja e transparencës ndaj operatorëve dhe për këtë nevojitet ngritja dhe mirëmbajtja e web faqes së OSHP-se, për qasje dhe informata sa më të shpejta për palët e interesuara.
3. Vazhdimin e zbatimit të strategjisë së komunikimit, e cila synon zhvillimin e marrëdhënieve me publikun e brendshëm dhe të jashtëm, me angazhim të plotë të stafit me qëllim të efektivitetit dhe eficiencës së punës së institucionit.
4. Një bashkëpunim të gjerë me operatorët ekonomik, autoritetet kontraktuese, Agjencinë Qendrore të Prokurimit, Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, me mediat, grupet e interesuara dhe publikun e gjerë.
5. Informimin në mënyrë të rregullt dhe transparent për veprimtarinë e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), nëpërmjet krijimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe lehtësisht të monitorueshëm nga komuniteti i biznesit dhe publiku i lidhur marrjen e vendimeve nga ana e OSHP-se.

Për të përmbushur objektivat lartcekura OSHP-së i nevojitet edhe krijimi i katër pozitave të reja për Ekspert Shqyrtues dhe dy pozita për staf administrativ, dhe për këtë nevojitet shtim i buxhetit.

Si objektiva në vazhdimësi për OSHP-se në planin afatmesëm mbetet:

- Ngritja e mëtutjeshme e kapaciteteve profesionale, mirëpo për shkak të planifikimeve buxhetore rrezikohet që të mos implementohet për shkak se trendët e financimit tregojnë zvogëlim të buxhetit sidomos në kategorinë mallra dhe shërbime.
- Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare në mënyrë që rregullat e prokurimit publik të jenë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe shkëmbimi i përvojave me ekspert vendor dhe ndërkombëtar me qëllim që të përmbushen objektivat e parapara.

Tabela 1: Trendët e financimit 2015-2016 dhe vlerësimet 2017-2019

Organizata Buxhetore	Viti 2015 shpenzimi	Viti 2016 Buxheti 2015	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar	2018 Vlerësuar
Total	291,838.29	329,883.00	329,883.00	329,883.00	329,883.00
Nr. i punëtorëve	22	23	23	23	23
Pagat dhe Mëditjet	185,026.12	210,428.00	210,428.00	210,428.00	210,428.00
Mallrat dhe Shërbimet	105,349.20	114,355.00	114,355.00	114,355.00	114,355.00
Shpenzimet Komunale	1,342.97	5,100.00	5,100.00	5,100.00	5,100.00
Subvencionet dhe Transferet	-	-	-	-	-
Shpenzimet Kapitale	-	-	-	-	-
Burimet e Financimit	291,838.29	329,883.00	329,883.00	329,883.00	329,883.00
Grantet qeveritare	291,838.29	329,883.00	329,883.00	329,883.00	329,883.00
Të hyrat vetanake					
Financimet nga huamarrjet					
Grantet nga donatorët					

OSHP nuk ka projekte për investime kapitale andaj edhe nuk parashihen në KASH 2017-2019